



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT**

Nr.            prot.

Tiranë, më,    .\_\_\_\_.2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**  
**( NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

**Drejtuar:** “Marketing & Distribution” shpk me Administrator Z. Besnik Nushi me Nipt:J72124001N, Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 10, Kashar, Rruga Iliria, Nr. 53

**Procedura e prokurimit/lotit:** “E Hapur e Thjeshtuar”, Mall - me mjete elektronike.

**Numri i procedurës / referenca e Lotit:** REF-06288-05-23-2024.

**Përshkrimi i shkurtër i kontratës:** “Blerje Kancelari”

**Fondi limit:** 1.628.611,00 (një milion e gjashtëqind e njëzet e tetë mijë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

**Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:** 25 (njetzet e pese) dite nga data e nenshkrimit te kontrates.

**Publikimet e mëparshme** ka pasur: Buletini Nr. 14 datë 11 Mars 2024

**Buletini i Njoftimeve Publike:** Buletini Nr. 27 datë 27 Maj 2024

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Bazuar në **Vendimin Përfundimtar Nr. 738/2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, dt.24.06.2024** i cili vendosi mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ‘‘InfoSoft Office’’ shpk si dhe AK të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave realizon ‘‘Hapjen e procedurës’’ të ofertave të paraqitura në sistemin elektronik të APP- së ku u paraqitën **4 (katër) ofertues** me vleren perkatëse si vijon:

**1. ‘‘InfoSoft Office’’ SHPK**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**J62426002Q**

*numri i NIPT-it*

Vlera: 1 616 999.98 [një milion e gjashtëqind e gjashtembedhjetë mijë e nentëqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë nëntëdhjetë e tetë] **lekë pa TVSH.**

**2. ‘‘IT Gjergji Kompjuter’’ SHPK**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**K81503063B**

*numri i NIPT-it*

Vlera: 1,621,000.00 [një milion e gjashtëqind e njëzet e një mijë] **lekë pa TVSH.**

**3. ‘‘Librari Dyrrahu’’ SHPK**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**L91418502J**

*numri i NIPT-it*

Vlera: 1,061,100.00 [një milion e gjashtedhjetë e një mijë e njëqind] **lekë pa TVSH.**

**4. ‘‘Marketing & Distribution’’ SHPK**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**J72124001N**

*numri i NIPT-it*

Vlera: 1,290,474 [një milion e dyqind e nëntëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e katër] **lekë pa TVSH.**

Pasi KVO shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomik dhe kontrollon ofertat ekonomike për gabime matematikore, konstatuan se 3 operatore ekonomik kualifikohen në fazën e metejshme të kesaj procedurë, ndërsa operatori ekonomik ‘‘Librari Dyrrahu’’ SHPK me nr. NIPT L91418502J ka oferte anomalisht të ulët.

**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

**1. ‘‘Librari Dyrrahu’’ SHPK me nr. NIPT L91418502J, për arsyet e mëposhtme:**

Rezultoi se oferta ekonomike është anomalisht e ulët. Referuar nenit 27 pika 5 e Ligj nr. 16/2024‘‘Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 162/2020 ‘‘Për Prokurimin Publik’’ parashikohet: ‘‘Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët’’

*Klasifikimi u bë me datë 31.07.2024 në sistemin elektronik të APP-së.*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se Ofertuesi Ekonomik: **“Marketing & Distribution” shpk me Administrator Z. Besnik Nushi me Nipt:J72124001N, Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 10, Kashar, Rruga Iliria, Nr. 53 me oferte:** Vlera: 1,290,474 [një milion e dyqind e nentëdhjetë mijë e katerqind e shtatëdhjetë e katër] **lekë pa TVSH** është identifikuar si fitues i procedurës së prokurimit.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit të Qytetit, Tiranë me adresë: Rruga 5 Maji”, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5 ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Lidhja e kontratës bazuar nenit 85 të VKM 285 dt. 19.05.2021”Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” do të bëhet brenda 60 ditëve nga AK.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

**Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)**

PO       **JO X**

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Liri Qoshi**